



Kodi i Sjelljes së Vullnetarit

Në mënyrë që të bëheni vullnetar në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, nga aplikuesit kërkohet të plotësojnë Orientimin e Vullnetarit dhe të jenë dakord të ndjekin Kodin e Sjelljes së Vullnetarit:

- Unë do të paraqitem në shkollë dhe do firmos menjëherë për ardhjen.
- Unë do të ndjek udhëzimet e administratorit të godinës, mësuesve dhe/ose personelit të caktuar.
- Unë jam dakord që të sillem si profesionist dhe me respekt gjatë gjithë kohës. Unë e kuptoj që vullnetarët përbëjnë shëmbuj për nxënësit dhe do të sillem ashtu siç kërkohet, gjatë gjithë kohës.
- Unë e kuptoj që jam përgjegjës për ndjekjen e politikave dhe procedurave të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Unë e kuptoj që SDP ka një përkushtim të madh ndaj diversitetit dhe përfshirjes të të gjithë nxënësve. Unë do t'i mbështes këto politika dhe vlera gjatë kohës së punës vullnetare. Gjatë kohës së vullnetarizmit, unë nuk do të ndaj me nxënësit pikëpamjet e mija politike dhe personale. Nëse do të kem ndonjë pyetje rreth këtyre temave, Unë do të pyes mësuesin ose drejtorin.
- Unë do të ndaj me mësuesit dhe/ose administratorin e shkollës çdo problem që lidhet me mirëqënien e nxënësve dhe/ose sigurinë e tyre.
- Unë do të përdor vetëm banjot e përcaktuara për të rriturit.
- Unë nuk do të mbaj me vete armë të asnjë lloji gjatë kohës që do të jem në mjediset e shkollës, ose në aktivitetet e saj jashtë mjediseve shkollore.
- Unë nuk do të mbaj ose do të tymos duhan, ose produkte që kanë në përbajtje nikotinë dhe nuk do të mbaj, ose do të jem nën ndikimin e alkoolit, marijuanës, ose drogave ilegale në mjediset shkollore, ose gjatë aktiviteteve jashtë mjediseve shkollore.
- Unë e kuptoj, që gjatë periudhës së vullnetarizmit, Unë mund të marr dijeni për informacione private, ose sensitive ndaj nxënësve, familjeve, ose personelit. Unë jam dakord që të ruaj konfidencialitetin e këtij informacioni jashtë shkollës. Unë nuk do t'a ndaj informacionin për nxënësit, ose personelin me ndonjë njeri tjetër, dhe do të plotësoj detyrat e mia si vullnetar, siç theksohet në kodin e sjelljes.
- Unë jam dakord që të shmang shfrytëzimin, ose ndikimin e padrejtë ndaj një nxënësi, për përfshirjen e tij në një akt jo ligjor, ose imoral, ose të një sjelljeje e cila mund të jetë subjekt disiplinor për sjellje të padenjë, pavarësisht nëse nxënësi përfshihet në këtë lloj sjelljeje.
- Unë jam dakord që të mos përfshihem në ngacmime seksuale ndaj nxënësve, vullnetarëve të tjerë, ose punonjësve të shkollës. Unë do të shmang kontaktet e padenja me ndonjë nxënësi, pavarësisht nëse është ose jo në mjedisin shkollor, të cilat përfshijnë të gjitha format e prekjes seksuale, marrëdhëniet seksuale, raporte romantike, ose çdo prekje e cila është e papranueshme për nxënësin, ose që është jo e duhur për një moshë të caktuar, për gjininë dhe pjekurinë e nxënësit. Unë do të jem i përmbajtur ndaj prekjes dhe përqaimit të nxënësve, edhe në rastin kur kontakti fizik nxitet nga nxënësi.
- Unë jam dakord që të njoftoj menjëherë Departamentin e Shërbimeve të Sigurisë, nëse unë jam i arrestuar për kundërvajtje ose krim, si dhe shkelje që lidhen me seksin, drogën, sulmin, ose armët.

Unë dakortësohem të ndjek këtë Kod Sjellje, standardet e përgjithëshme të sjelljes profesionale dhe të ruaj konfidencialitetin. Unë e kuptoj që të qënit vullnetar është një privilegj, jo një e drejtë. Unë e kuptoj se mosveprimi sipas këtyre standardeve, do të jetë bazë për pezullimin e mënjëhershëm, ose përjashtimin e përhershëm të privilegjeve të mija si vullnetar.

EMRI (PRINT): _____ DATA: _____

EMAIL: _____ NUMRI I TELEFONIT: _____

FIRMA: _____

FOR PRINCIPAL/ADMINISTRATOR USE ONLY

I certify that the Volunteer Packet of the above listed individual is complete; that I have reviewed the background clearances and determined that there are no offenses or the offenses listed do not prohibit the individual from volunteering; and that this individual may begin volunteering in my school building on the date that I have written below.

PRINCIPAL/ADMINISTRATOR NAME: _____

PRINCIPAL/ADMINISTRATOR SIGNATURE: _____ DATE: _____